REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org.
Org.Jedinica
Org Unit 02
Nr.Prot:
Broj Prot:
Prot No 05-4806
Nr.i faqeve
Br.strenica
No.pages -6-
Data:
Datum:
Date: 08 / 07 / 2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: MARRJA, TRANSPORTI DHE KULTIVIMI BAKTERIAL I STRISHOS CERVICALE (ITGJ02/V1.0)

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË TË MARRJES SË MOSTRAVE, TRANSPORTIT DHE KULTIVIMI BAKTERIAL I STRISHOS CERVICALE, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR PËR IDENTIFIKIMIN E BAKTERIEVE PATOGJENE NË STRISHO CERVICALE

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT:07.07.2026
AUTOR: MSH/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE: 24

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

V.V

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HAELTH
Prishtinë / a

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR MARRJEN E MOSTRËS, TRANSPORTIN DHE KULTIVIMIN E STRISHOS CERVICALE. PROCEDURA E PËRSHKRUAR DUHET TË ZBATOHET NGA GJITHË PERSONELI LABORATORIK.
NDËRLIDHJA ME AKTET	• LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE, • PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; • DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË; • EUCAST CLINICAL BREAKPOINTS AND DOSING OF ANTIBIOTICS 2026.
LISTA E SHKURTESAVE	• PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE; • PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE; • EUCAST- EUROPEAN COMMITTEE ON ANTIMICROBIAL SUSCEPTIBILITY TESTING; • MRSA-METHICILLIN RESISTANT STAPHYLOCOCCUS AUREUS; • ITGJ- INFEKSIONET E TRAKTIT GJENITAL; • MALDI-TOF- MATRIX-ASSISTED LASER DESORPTION/IONIZATION TIME-OF-FLIGHT.

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	1. Mostra merret nga gjinekologu/infermieri në ordinancën gjinekologjike; 2. Mostra transportohet deri në laboratorin e diagnostikimit të mostrave gjenitale; 3. Laboranti kryen pranimin, inspektimin dhe ndarjen sipas kritereve të pranimit/refuzimit të përcaktuara në Doracakun e Cilësisë;
[II]	Reagjentët dhe pajisjet që janë të nevojshme për testim:	1. Sigurohu që të gjitha pajisjet dhe reagjentët e mëposhtëm janë të disponueshëm dhe funksionalë para fillimit të testimit; **1.1.Pajisjet përfshijnë:** a. Flaka e Bunsenit; b. Ansa bakteriologjike me majë shpuese me dorëz metalike; c. Inkubator 37° C, O_2; d. Inkubator 35-37° C, 5-10% CO_2; e. Inkubator 24-27 ° C; f. Frigorifer 4-8° C dhe -20° C; g. Turbidometri; h. Pipeta automatike 20-100 µl; i. Vazhduese të pipetës 100 µl; j. Sistemi identifikues automatik (Vitek, MALDI-TOF); k. Vizorja, matësi i zonës së inhibimit; **1.2.Reagjentët e nevojshëm:** a. H_2O_2 3 %; b. Disqet e Bacitracinës (0.04 njësi); c. Disqet e Antibiotikëve; d. Kiti për ngjyrosjen Gram; e. Alkool 70 % dhe 96%; f. Kiti komercial i përcaktimit antigjenik të grupeve Lancefield të Streptokokut; g. NaCl 0.9%; h. Testi i Koagulazës; i. Testi i Optohinës; j. Testi i Oksidazës; k. Terreni kromatik për MRSA. **1.3.Materiali:** a. Mediumet ushqyese; b. Ansa bakteriologjike një përdorimëshe; c. Dorëza Nitrile një përdorimëshe S,M, L; d. Qese Biohazard dhe laps-ngjyrë e përhershme; majë e dyfishtë; e. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM); f. Pako akulli, çantë transporti;

[III]	Veprimet laboratorike të marrjes dhe transportit të mostrës	1. Vendoset spekulumi pa lubrifikant (ose me lubrifikant ujor minimal); 2. Hiqet mukusi me tamponin e parë (hedhet); 3. Futet tamponi steril në kanalin endocervikal ~1 cm dhe lihet disa sekonda; 4. Largohet pa prekur muret vaginale; 5. Vendoset në medium transportues; 6. Transportohet: a. brenda 2 orëve; b. deri 24 orë me medium transportues;
[IV]	Veprimet e laboratorike të kultivimit	1. Verifikohen mediumet dhe kontrollet e cilësisë; 2. Shënjohet Agar Gjak me ID të mostrës; 3. Inokulimi bëhet me teknikë aseptike; 4. Inkubohet në (sipas tabelës 1 të shtojca 1): a. 35–37°C; b. 5–10% CO_2; c. 16–24 orë, me lexim në 24–48 orë; d. Kultivime shtesë sipas kërkesës së mjekut (p.sh. Candida, gonohrrea);
[V]	Veprimet e laboratorike të kultivimit	1. Mikrobiologu ekzaminon mediumet ushqyese pas inkubimit 24h-48 h, praninë e rritjes së baktereve ku kolonitë bakteriale analizohen bazuar në: a. madhësi; b. ngjyrë; c. morfologjinë; d. vetitë hemolitike (alfa, beta, ose gamma); e. modelet e inhibicionit të rritjes (p.sh., në MacConkey agar) dhe çdo veçori tjetër dalluese të kolonive; 2. Nëse mikrobiologu përcakton se kultura ka rezultuar negative në prani të kolonive të baktereve patogjene pas 24-48 h inkubimi, nuk kërkon shtesë për përpunim të mëtejmë dhe raporton rezultatin si: **"Nuk ka rritje te baktereve patogjene";** 3. Nëse ka rritje të dyshimtë të kolonive të baktereve patogjene, mikrobiologu specifikon cilat teste adekuate biokimike (ose sisteme të automatizuara), varësisht nga izolati i dyshuar, duhet të performohen dhe t'i shënojë në listën përcjellëse të mostrës. Këto teste biokimike përfshijnë: 4. Kolonitë e dyshimta testohen me: a. Test Katalaze; b. Test koagulaze; c. Identifikim Streptococcus (gr. A, B, C, G); d. Test oxidazë;

		e. MALDI-TOF ose Vitek; 5. Testimi i ndjeshmërisë sipas EUCAST 2026; 6. Mostrat e përpunuara vendosen në termostat në kushte të caktuara inkubimi varësisht nga lloji i testit dhe sipas udhëzimit të përdorimit të tyre; 7. Mikrobiologu lexon dhe interpreton testet e performuara dhe regjistron të dhënat përfundimtare të testimit;
[VI]	Veprimet e laboratorike të raportimit të rezultatit	1. Laboranti vendos të dhënat e regjistruara në fletëpërcjellëse nga ana e mikrobiologut në sistemin informativ të laboratorit; 2. Laboranti vendos të dhënat në librin e protokolit të laboratorit, respektivisht në databazat përkatëse të laboratorit; 3. Mikrobiologu bën raportimin e rezultateve duke përfshirë verifikimin e saktësisë së analizave të raportuara nga laboranti, të dhënat për patogjenët e identifikuar, testin e ndjeshmërisë dhe çdo koment ose rekomandim shtesë ;

Shtojca 1.

Tabela 1. Patogjenet, mediumet ushqyese dhe kushtet e inkubimit.

Mostra	Terreni	Inkubacija			leximi	Mikroorganizm at e kerkuar
		Temp. (°C)	Atmosfera	Koha		
Strisho cervicale	Agar gjak	35-37	5-10% CO_2	16-24 h	24-48 h	*Streptococcus* gr. A, B, C , G